



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2019:095968

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06088343

**C.nr.1699/2018**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtorin profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridiko - kontestimore të paditësve-kundërpaditurve Z.S. me numër personal ..... dhe P.S. me numër personal ..... të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson A.H. avokat nga Prizreni, kundër të paditurve-kundërpaditësve G.S. me numër personal .... dhe M.S. me numër personal .... nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson Y.K. avokat nga Prizreni, me objekt të padisë: zbrazja dhe dorëzimi paluajtshmërisë dhe objekt të kundërpadisë: vërtetimi i të drejtës së pronësisë, pas seancën së shqyrtimit kryesor-publik me datë 05.07.2024 në prani të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, paditësit – kundërpaditurit Z.S. dhe të të paditurive-kundërpaditësve, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditësve -kundërpaditurve Z.S. dhe P.S. që të dy nga Prizreni.

- **DETYROHET** i padituri – kundërpaditësi G.S. nga Prizreni, që të liron - zbraza nga të gjitha personat dhe gjësendet sipërfaqen prej 2.0 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.75m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 1.33m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.45m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në vijë të lakuar në gjatësi prej 1.39m (0.55 + 0.84m), pronë e paditësve-kundërpaditurve Z.dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-.... ZK Prizren, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- **DETYROHET** i padituri – kundërpaditësi M.S. nga Prizreni, që të liron - zbraza nga të gjitha personat dhe gjësendet sipërfaqen prej 0.69 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.41m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.63m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi

prej 1.44m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.34m, pronë e paditësve-kundërpaditurve Z. dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

- II. APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesa nga kundërpadia e të paditurit – kundërpaditësit M.S. nga Prizreni, ashtu që **VËRTETOHET** se i padituri-kundërpaditësi M.S. është pronar i sipërfaqe prej 1.19 m<sup>2</sup> e pjesës së ngastrës kadastrale me nr.2053-0 ZK Prizren, (sipërfaqe në të cilën ndodhet e ndërtuar shtëpia e të paditurit- kundërpaditësit M.S. me katshmëri B+P+), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.39m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.73m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.41m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.98m, ashtu që **DETYROHEN** paditësit – të kundërpaditurit Z.S. dhe P.S. të dy nga Prizreni, të pranojnë këtë dhe të lejojnë që i padituri –kundërpaditësi M.S. të regjistrohet në librat kadastral në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.
- III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve -kundërpaditurve Z. dhe P.S. që të dy nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET i padituri – kundërpaditësi M.S. nga Prizreni, që të liron - zbraz nga të gjitha personat dhe gjësendet sipërfaqen prej 1.19m<sup>2</sup> (sipërfaqe në të cilën ndodhet e ndërtuar shtëpia e të paditurit- kundërpaditësit M.S.), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.39m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.73m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.41m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.98m, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, **REFUZOHET e pa bazuar.**
- IV.** Pjesa tjetër e kërkesës nga kundërpadia e të paditurit –kundërpaditësit M.S. me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të parashkrimit fitues është pronarë edhe i sipërfaqes prej 0.69 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.41m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.63m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.44m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.34m, pronë e paditësve-kundërpaditurve Z.S. dhe P.S. pjesë e ngastrës kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, **REFUZOHET e pa bazuar.**
- V. REFUZOHET në tërësi e pabazuar** kërkesa nga kundërpadia e të paditurit – kundërpaditësit G.S. me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të parashkrimit fitues është pronarë i sipërfaqes prej 2.00 m<sup>2</sup> ( sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore nga pika 1 deri në pikën 2 në gjatësi të përgjithshme prej

1.75m, nga ana Veriore nga pika dy deri në pikën 3 në gjatësi prej 1.33m, nga ana Perëndimore nga pika 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.45m dhe nga ana Jugore nga pika 4 deri në pikën 1 ne vijë te lakuar në gjatësi prej 1.39m (0.55 + 0.84m), pronë e paditësve-kundërpaditurve Z.S. dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-.... ZK Prizren.

**VI. DETYROHET** i paditësit G.S. që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajnë paditësve Z.S. dhe P.S. shumën prej 2,109.20 euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### *1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësit Z.S. dhe P.S. që të dy nga Prizreni përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 11.04.2024, ndaj të paditurve G.S. dhe M.S. të dy nga Prizreni, për shkak të zbrazjes dhe dorëzimit të paluajtshmërisë.

Në padinë e paraqitur, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë bashkëpronarë me nga  $\frac{1}{2}$  e paluajtshmërisë, e cila evidentohet në bazë të certifikatës mbi të drejtën e pronës së paluajtshme me numër të njësisë kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, në sipërfaqe të përgjithshme prej 18 m<sup>2</sup>. Paditësit përkundër faktit se janë pronarë juridik të sipërfaqes së përgjithshme prej 18 m<sup>2</sup>, të njëjtit në teren e shfrytëzojnë sipërfaqen prej 16 m<sup>2</sup>, pra të njëjtëve u mungon sipërfaqja prej 2.00 m<sup>2</sup>, të cilën të paditurit e shfrytëzojnë pa asnjë bazë ligjore. Edhe pse paditësit kanë tentuar të bisedojnë me të paditurit që këtë çështje ta zgjidhin me marrëveshje, në atë mënyrë që paditësve të iu dorëzohet prona në shfrytëzim të lirë mirëpo kjo nuk ka mundur q të realizohet. Andaj, në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovon në tërësi të bazuar.

Edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtur, i autorizuari i paditësve – të kundërpaditurve ka qëndruar në tërësi pranë padisë së paraqitur, ndërsa me parashtrësën e datës 11.04.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë së paraqitur në aspektin objektiv. Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, i autorizuari i paditësve të kundërpaditurve, ka deklaruar se në mes palëve ndërgjyqëse është zhvilluar procedura pranë kësaj gjykate për rregullimin e mexheve, ndërsa me datë 31.10.2018, paditësit kanë paraqitur padinë për zbrazjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë dhe se me pa mëdyshje është vërtetuar baza e padisë se këtu paditësit janë pronarë të ngastrës kadastrale 2053-0 në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>, e cila gjendet në rrugën ish “Karl Marsi”, tani “Adem Jashari”. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve-të kundërpaditurve ka bërë precizimin e kërkesëpadisë sa i përket pjesës së lirë të hapësirës të konstatuar në ekspertizën e gjeodezisë. Pasi që padia dhe kërkesëpadia e paditësve është vërtetuar në tërësi dhe pa asnjë mëdyshje është vërtetuar se të paditurit – kundërpaditësit sipërfaqen e përgjithshme prej 3.88 m<sup>2</sup>, të ngastrës 2053-0, e mbajnë në shfrytëzim pa mirëbesim, kanë hyrë në posedim pa asnjë bazë ligjore, kanë pasur probleme të vazhdueshme

jo vetëm fqinjësore por edhe gjyqësore, madje kanë pasur njohuri që kjo pjesë nuk i përket ngastrave të tyre, sepse të paditurit në vitet 1984, kanë zhvilluar procedurat për marrjen e lejeve të ndërtimit të shtëpive dhe janë përcaktuar kufijtë e ngastrave të këtu të paditurve duke mos e përfshirë pjesën e ngastrave e cila i përket paditësve, duke shtuar edhe njoftimin që paditësit i kanë bërë në vitin 1999, se e kanë blerë pronën dhe sipas shitësve kanë sipërfaqe mbrapa lokalit, ndërsa nga viti 2014, kanë filluar procedurat gjyqësore fillimisht me propozim për rregullimin e mexhëve, e pastaj me padi edhe për dorëzimin e pronës, duke i propozuar gjykatës që kundërpadia e të paditurve-kundërpaditësve të refuzohet. Me pretendimet e të paditurve, nuk mund të bëhet fjalë për fitimin e të drejtës së pronës me parashkrim fitues sipas nenit 28.4 të LMTHPJ, pas që përveç posedimit të sendit dhe kohëzgjatjes së posedimit prej 20 viteve, kërkohet që posedimi të jetë me mirëbesim, gjë që në rastin konkret nuk përmbushen kushtet ligjore të paraparë me këtë dispozitë ligjore. Nga administrimi i provave materiale dhe dëgjimi i dëshmitarëve me pa mëdyshje është vërtetuar se paditësit janë bashkëpronarë të ngastrës 2053-0, të cilën e kanë fituar me kontratë për shitblerjen e vitit 1999 dhe në listën poseduese është vërtetuar se paditësit janë bashkëpronarë me nga ½, po ashtu është vërtetuar se të paditurit – kundërpaditësit pa asnjë bazë e mbajnë në posedim me keqbesim dhe shfrytëzim pjesë nga ngastrat e paditësve. Nga prova materiale Kontrate për shitblerjen e datës 16.09.2021, e lidhur nga palët, vërtetohet fakti se i padituri e ka ditur se pronarë të pjesës kontestuese janë paditësit. Tutje ka shtuar se deklaratimet e dëshmitarëve Durime dhe Gjemile Aksalin, nuk përputhen me deklaratimet e palëve të cekura në kundërpadi, përgjigje në padi, e as në seancën e datës 25.04.2025. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadija e paditësve të aprovohet në tërësi e bazuar, ndërsa kërkesa nga kundërpadia të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar, ashtu si janë specifikuar në fjalën përfundimtare.

Të paditurit-kundërpaditësit në këtë çështje juridike kontestimore brenda afatit ligjor kanë paraqitur përgjigje në padi, përmes të cilës e kanë kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, duke theksuar se të njëjtit parcelat e veta kadastrale, që në të vërtet janë shtëpitë e tyre i shfrytëzojnë që nga lindja e tyre, meqenëse kanë lindur në këto shtëpi, si dhe edhe prindërit e tyre në këto vija kufizuese i kanë shfrytëzuar shtëpitë e tyre familjare. Me parashtrësën e datës 27.10.2021, të paditurit – kundërpaditësit përmes të autorizuarit të tyre në këtë çështje kontestimore kanë paraqitur kundërpadi duke kërkuar që gjykata të refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve ndërsa të aprovon kërkesën nga kundërpadia dhe të vërtetohet se të paditurit – kundërpaditësit janë pronarë në bazë të mbajtjes me mirëbesim të sipërfaqes prej 2 m<sup>2</sup>, nga parcela me numër 2053-0 ZK Prizren.

Edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtur, i autorizuari i të paditurve – kundërpaditësve ka qëndruar pran padisë dhe kundërpadisë së paraqitur, ndërsa me parashtrësën e datës 15.05.2024, kanë paraqitur precizimin e kërkesës nga kundërpadia, të cilën e kanë plotësuar me parashtrësën e datës 04.07.2024. Në fjalën përfundimtare të paraqitur me shkrim i autorizuari i të paditurve-kundërpaditësve ka theksuar se me aktvendimin me shenjë C.nr.209/76, të datës 11.05.1976, në lëndën e paditësve S. dhe D.B. ndaj të paditurit R.M. i cili është babai i të paditurit M.S. në

procedurë të pengim posedimit është konstatuar se ekziston ndërhapësira që gjendet prapa dyqanit të paditësve dhe shtëpisë së të paditurve – kundërpaditësve. Në ekspertizën sipas aktgjykimit me shenjën C.nr.2069/76, vërtetohet se ndërhapësira kontestuese është pronësi e babës së të paditurit – kundërpaditësit M.S. kurse ekspertiza e kryer nga eksperti K.G. nuk mund të pranohet sepse është e pasaktë dhe e punuar nga eksperti i cili nuk është në listën e ekspertëve të licencuar. Gjykata, së bashku me ekspertin e ndërtimitarisë dhe palët ndërgjyqëse, ka dalë në vend dhe drejtpërdrejtë dhe është konstatuar se në pjesën e prapme të murit të lokalit të paditësve-kundërpaditurve, e cila kufizohet me ndërhapësirën kontestuese, nuk ka dritare, dyer apo ndonjë hapësirë tjetër që përmes të cilës mund të dilet në këtë hapësirë, meqenëse u konstatua se në këtë ndërhapësirë hyrje dhe dalje kanë vetëm të paditurit-kundërpaditësit. Nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimitarisë është konstatuar se lokali afarist në parcelën nr.2053-0, është ndërtuar para vitit 1932, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor dëshmitarët Gj.A. dhe D.K. deklaruan se ajo hapësirë kontestuese është e të paditurve-kundërpaditësve, të cilën vetëm ata e shfrytëzojnë, kurse muri i lokalit të paditësve – të kundërpaditurve, që kufizohet me murin shtëpinë e të paditurit-kundërpaditësit dhe ndërhapësirën kontestuese, nuk ka dyer dhe dritare, po ashtu hyrja dhe dalja në këtë ndërhapësirë ekziston vetëm nga shtëpia e të paditurve – kundërpaditësve. Nga të gjitha konstatimet e bëra nga gjykata, eksperti i ndërtimitarisë dhe dëshmitarët e dëgjuar, konstatohet se të paditurit-kundërpaditësit nga shtëpitë e tyre këtë ndërhapësirë kontestuese e shfrytëzojnë dhe e posedojnë që nga viti 1932, pa u penguar nga askush, me mirëbesim, e deri me sot plot 92 vite e shfrytëzojnë. Nga kopja e planit për lokalit e paditësve – kundër të paditurve që shtrihet në parcelën me numër 2053, të datës 28.10.1999, shënohet se është me kulturë jopjellore dhe shtrihet në rrugën ..... në sipërfaqe prej 2 m<sup>2</sup> dhe si ndërtesë në sipërfaqe prej 16 m<sup>2</sup>, gjithsej në sipërfaqe prej 18 m<sup>2</sup>, nga e cila mund të konstatohet se pjesa kontestuese prej 2 m<sup>2</sup>, që kërkojnë paditësit-të kundërpaditurit gjendet në rrugën ..... si jopjellore, e jo në pjesën e prapme të lokalit të paditësve – të kundërpaditurve, që kufizohet me shtëpinë e të paditurve – kundërpaditësve. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësve – të kundërpaditurve dhe të aprovohet në tërësi kundërpadia e të paditurve – kundërpaditësve M.S. dhe G.S.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i kanë kërkuar, ashtu si janë specifikuar në parashtrësën të cilën ia kanë bashkangjitur fjalës përfundimtare.

## 2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë të datës 20.01.2023, të punuar nga eksperti i gjeodezisë K.G. si dhe deklarimi i ekspertit në shqyrtimin kryesor të datës 07.04.2023; leximi i certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale P-02053-0, të datës 17.09.2018, të lëshuar nga zyra kadastrale në Prizren; aktvendimi me shenjën C.nr.209/76, të datës 11.05.1976, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren; aktvendimi me nr.04/4-353-1072, të datës 22.05.1984, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren; aktvendimi me nr.04/4-351-238, të datës 25.08.1984, të

lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren; aktvendimi me nr.03/3-463-321, të datës 04.01.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren; aktvendimi me nr.04/4-353-1485, të datës 11.04.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren; aktvendimi me nr.04/4-351-174, të datës 26.04.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren; aktvendimin e lëshuar nga drejtori i punëve të brendshme pranë Këshillit Ekzekutiv Krahinor të Këshillit Popullor Krahinor të KAKM, me numër rendor 215/H, i datës 10.11.1947, Prishtinë; kontratën mbi shitblerjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë e lidhur në mes të shitësit G.G. dhe blerësit Z.dhe P.S. e datës 16.09.2021, e lidhur pranë zyrës së avokatit Y.K. marrëveshja mbi prishjen e kontratës mbi shitblerjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë e datës 16.09.2021, e lidhur pranë zyrës së avokatit Y.K. me datë 04.10.2021; leximi i skicës së matjes për ngastrën kadastrale 2059-1, nga gjeodet i licencuar N.Sh. Geoline, e datës 16.09.2015; certifikatën e vdekjes me numër të referencës 20/1980RV/20001, datë 12.04.2023, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren për të ndjerin R.S. ish nga Prizreni; ekstraktin nga regjistri qendror të gjendjes civile me numër serik E26958240, të datës 12.04.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren për paditësin M.S. raportin për njësinë kadastrale P-02053-0, të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me datë 20.09.2021; leximi i kopjes nga lista poseduese me numër 299, datë 22.09.1995, e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Prizren, për parcelën me numër 2053, 2163 dhe 3387; ekspertizën e ndërtimtarisë e punuar nga eksperti S.D. me datë 25.10.2023, e protokolluar me datë 26.10.2023, si dhe dëgjimi i ekspertit në shqyrtimin e datës 11.01.2024; dëgjimin e dëshmitares Gj.A. në shqyrtimin e datës 04.04.2024; dëgjimin e dëshmitares D.K. në shqyrtimin e datës 04.04.2024; dëgjimin e paditësit – të kundërpaditurit Z.S. në shqyrtimin e datës 25.04.2024; dëgjimin e të paditurit – kundërpaditësit G.S. në cilësi të palës, në shqyrtimin e datës 25.04.2024; dëgjimin e të paditurit – kundërpaditësit M.S. në cilësi të palës, në shqyrtimin e datës 25.04.2024; shikimi në fotografinë kolor të formatit A4, të dorëzuar nga i autorizuari i paditësve me datë 20.05.2024; shikimi në skicën e prezantuar nga i autorizuari i të paditurve – kundërpaditësve në seancën e datës 05.07.2024, në formatin A4;

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

*kërkesëpadia e paditësve – të kundërpaditurve është pjesërisht e bazuar.*

*kërkesëpadia e të paditurit – kundërpaditësit Muhamed Surdulli është pjesërisht e bazuar*

*kërkesëpadia e të paditurit – kundërpaditësit Gani Sunduri është në tërësi e pabazuar*

Nga leximi i ekspertizës së gjeodezisë të datës 20.01.2023, të punuar nga eksperti i gjeodezisë K.G. gjykata vërtetoi faktin se është bërë identifikimi i ngastrës kadastrale me numër 2053-0 ZK Prizren, në vendin e quajtur tani rruga ..... në këtë ngastër gjendet objekti afarist-argjendari në shfrytëzim të paditësve. Sipërfaqja kontestuese gjendet në anën Lindore të këtij objekti në

kufi me ngastrat nr.2059-1 dhe 2059-2 ZK Prizren. Në ngastrën nr. 2059-1, i padituri-kundërpaditësi Muhamet Surduli ka të ndërtuar objektin e banimit në katëshmëri B+P+2. Në anën perëndimore -mbrapa këtij objekti deri tek objekti afarist të paditësve gjendet një hapësirë e vogël. Në ngastrën nr.2059-2 i padituri-kundërpaditësi G.S. ka të ndërtuar objektin e banimit B+P+2. Në anën Veri-perëndimore (mbrapa) këtij objekti ngjitur me objektin afarist te paditësve gjendet objekti në katëshmëri P+0 (banjo) e cila shfrytëzohet nga i padituri-kunderpaditesi. Pas matjes detale me 03.12.2022, në prezencën e palëve ne procedure dhe shikimit në operatin kadastral, eksperti ka konstatua se në bazë të të dhënave për pronat dhe pronarët në programin "KCID" i formuar nga të dhënat e programit për pronat dhe pronarët "BORMEN" i cili ka hy në fugi në vitin 1986, konstatohet se ngastra kadastrale nr.2053-0 në vendin e quajtur ish rruga "K.Marksi" tani rruga ..... me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 16m2 dhe oborr në sipërfaqe prej 2m2 e në sipërfaqe të përgjithshme prej 18m2 evidentohet në fletën poseduese nr. 2994 ZK Prizren, në emër të S.M.B. nga Prizreni. Në vitin 1995 numri rendor i regjistrimit të ndërrimeve 98/1995 ZK Prizren, kjo ngastër si e tërë kalon në bashkëpronësi në emër të J.S. me ½ pjesë ideale dhe K.T. me ½ pjesë ideale por në mungesë të librave kadastrale nuk dihet baza juridike e këtij ndryshimi. Me kontratën mbi shitblerje Leg.nr.2348/201 Gjykata Komunale ne Prizren ngastra kadastrale nr. 2053-0, si e tërë kalon në fletë posedimin nr.10773 ZK Prizren në emër të F.S. nga Prizreni. Me Kontratën mbi Dhuratën LRP.nr.6610/14, Ref.nr.1329/14 të datës 22.09.2014, Noter O.G. ngastra nr. 2053-0 ZK Prizren, si e tërë kalon si bashkëpronësi në emër të Z.F.S. me 1/2 pjesë ideale dhe P.F.S. me 1/2 pjesë ideale te dy nga Prizreni ku evidentohet edhe tani. Sipas gjendjes së fundit në operatin kadastral ngastral ngastra kadastrale nr.2059-1 ZK Prizren në vendin e quajtur ish rruga "29 Nëntori" tani rruga ..... me kulturë shtëpi ne sipërfaqe prej 27m2 dhe oborr në sipërfaqe prej 44m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 71m2 evidentohet në emër të M.R.S. nga Prizreni. Sipas gjendjes së fundit në operatin kadastral ngastral ngastra kadastrale nr.2059-2 ZK, Prizren në vendin e quajtur ish rruga "29 Nëntori" tani rruga ..... me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 55m2 dhe oborr në sipërfaqe prej 31m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 8m2 evidentohet në emër të G.E.S. nga Prizreni. Ngastra kadastrale me numër 2053-0 ZK Prizren, në sipërfaqe të përgjithshme prej 18m2, është në kufijtë e vetë sipas planeve kadastrale me masat dhe dimensionet nga lindja në kufi me ngastrat nr.2059-1 dhe 2059-2 në gjatësi të përgjithshme prej 3.57m, nga Perëndimi në kufi me rrugën ..... ( ngastra nr. 4812-0) në gjatësi prej 3.10m, nga Veriu në kufi me ngastrën nr.2054-0 në gjatësi të përgjithshme prej 5.66m dhe nga Jugu në kufi me ngastrën nr. 2052-0 në vijë të lakuar në gjatësi të përgjithshme prej 6.42m. Paditësit - të kundërpaditurit e shfrytëzojnë lokalin afarist (Argjendari) në sipërfaqe prej 15.77m2. Por sipas të dhënave të gjendjes faktike dhe planeve kadastrale konstatohet se ky lokal në anën perëndimore është i shtrirë në ngastrën nr.4812-0 në sipërfaqe prej 1.53m2 ndërsa në ngastrën nr.2053-0 në sipërfaqe prej 14.24m2.

Në bazë të rezultatit te matjes detale dhe të dhënat grafike nga planet kadastrale eksperti ka konstatuar se i padituri-kundërpaditësi M.S. ne ngastrën nr.2059-1 LK Prizren e ka të ndërtuar objektin e banimit në katëshmëri B+P+2. Ky objekt është i shtrire në ngastrën nr.2053-0, ne sipërfaqe prej 1.19m2 me dimensione nga Lindja ne gjatësi të përgjithshme prej 1.39m, nga Perëndimi ne gjatësi prej 1.41m, nga Veriu ne gjatësi prej 0.73m dhe nga Jugu në gjatësi prej 0.98m. Në mes kësaj shtëpie dhe lokalit të paditësve gjendet një hapësirë e lire në sipërfaqe

prej 0.09m 2 me dimensionet nga Lindja ne gjatësi prej 1.41m, nga Perëndimi në gjatësi prej 1.44m, nga Veriu ne gjatësi prej 0.63m dhe nga Jugu në gjatësi prej 0.34m.

Ne baze te rezultatit të matjes detale dhe të dhënat grafike nga planet kadastrale konstatohet se i padituri-kundërpaditësi G.S. në ngastrën nr.2059-2 ZK Prizren e ka të ndërtuar objektin e banimit në katëshmëri B+P+2. Në anën Veri-perëndimore ka të ndërtuar aneksi-banjon ne katëshmëri P+0 i cili objekt është i shtrirë në ngastrën nr.2053-0 në sipërfaqe prej 2.0m2 me dimensione nga Lindja në gjatësi të përgjithshme prej 1.75m, nga Perëndimi në gjatësi prej 1.45m, nga Veriu ne gjatësi prej 1.33m dhe nga Jugu ne vijë te lakuar në gjatësi të përgjithshme prej 1.39m (0.55 + 0.84m). Ekspertizës së lartcekur, eksperti ia ka bashkangjitur edhe skicën e terrenit në shkallë të zvogëlimit 1:100, në të cilën me ngjyrë të kuqe është e paraqitur gjendja faktike ne vende, me ngjyrë te kaltër është i paraqitur lokali i paditësve dhe me ngjyrë te zezë është i paraqitur kufiri i ngastrës kad.nr.2053-0 ZK Prizren, sipas planeve kadastrale.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale P-02053-0, të datës 17.09.2018, të lëshuar nga zyra kadastrale në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale me numër P-71813068-..... në sipërfaqe prej 18 m2, evidentohet në emër të këtu paditësve – të kundërpaditurve Z.S. dhe P.S.

Nga i aktvendimit me shenjën C.nr.209/76, të datës 11.05.1976, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se pranë kësaj gjykate është zhvilluar procedura kontestimore në mes të S.B. dhe D.B. ndaj R.M. për çështjen kontestimore pengim posedimi dhe kërkesëpadia e paditësve në atë çështje ishte refuzuar si e pabazuar.

Nga leximi i aktvendimit me nr.04/4-353-1072, të datës 22.05.1984, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se të paditurit- kundërpaditësit M.S. nga Prizreni, i ishte lejuar lokacioni hapësinor për ndërtesa të banimit në rrugën e quajtur 29 nëntori, nr.3, në Prizren, në parcelën kadastrale numër 2059-1.

Nga leximi i aktvendimit me nr.04/4-351-238, të datës 25.08.1984, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se të paditurit- kundërpaditësit M.S. nga Prizreni, i ishte lejuar që të ndërtoj objektin e ri në ndërtesë banim familjar në Prizren, në rrugën “29 nëntori”, nr.3.

Nga leximi i aktvendimit me nr.03/3-463-321, të datës 04.01.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren, Drejtoria për Punë Juridike – Pronësore, gjykata vërtetoi faktin se është bartur e drejta e shfrytëzimit në tokën e nacionalizuar ndërtimore, e cila shtrihet në parcelën kadastrale nr.2059/2, në sipërfaqe prej 86 m2, pa kompensim për ndërtimin e ndërtesës familjare për banim me lokal në rrugën “29 nëntori”.

Nga leximi i aktvendimit me nr.04/4-353-1485, të datës 11.04.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se personit



të quajtur E.S. ngas Prizreni, i ishte lejuar lokacioni hapësinor për ndërtimin e ndërtesës familjare me lokal, në rrugën e quajtur 29 nëntori, nr.3, në Prizren, në parcelën kadastrale numër 2059-2.

Nga leximi i aktvendimit me nr.04/4-351-174, të datës 26.04.1989, të lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se personit E.S. nga Prizreni, i ishte lejuar që të ndërtoj objektin e ri ndërtesë banim familjar me lokal në Prizren, në rrugën “29 nëntori”, nr.3

Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë e lidhur në mes të shitësit G.S. dhe blerësit Z.dhe P.S. e datës 16.09.2021, e lidhur pranë zyrës së avokatit Y.K. gjykata konstatoi faktin se ishte lidhur marrëveshja e cila për objekt kishte hapësirën që gjendet në pjesën e prapme të njësisë kadastrale nr.2059/2 dhe që në kadastër evidentohet si pjesë e shitësit dhe se të njëjtit ishin dakorduar që rrënimi i WC-së, do të kryhej nga ana e shitësit, ndërsa shpenzimet e këtij rrënimi do ti barte blerësi.

Ndërsa nga marrëveshja mbi prishjen e kontratës mbi shitblerjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë e datës 16.09.2021, e lidhur pranë zyrës së avokatit Y.K. me datë 04.10.2021, gjykata konstatoi faktin se është lidhur marrëveshja për prishjen e kontratës së lartcekur.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes me numër të referencës 20/1980RV/20001, datë 12.04.2023, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se R.S. paraardhësi i të paditurit paditurit – kundërpaditësit M.S. ka vdekur me datë 05.04.1980 në Prizren.

Nga leximi i ekstraktit nga regjistri qendror të gjendjes civile me numër serik E26958240, të datës 12.04.2023, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se i padituri – kundërpaditësit M.S. është pasardhës i të ndjerit R.S. i cili ishte palë në kontestin sipas lëndës C.nr.209/76, zhvilluar në Gjykata Komunale në Prizren, me objekt kontesti për shkake të pengim posedimit.

Nga leximi i ekspertizës së ndërtimtarisë të punuar nga eksperti S.D. me datë 25.10.2023, e protokolluar me datë 26.10.2023, gjykata ka konstatuar se është bërë përshkrimi i përmbajtjes së objekteve, përshkrimi dhe identifikimi i materialit ndërtimor me të cilin janë ndërtuar objektet, paraqitja e etazheve të objekteve si dhe është bërë përcaktimi i vitit të ndërtimit të objekteve të cilat gjenden në parcelën kontestuese. Eksperti ka konstatuar se në parcelën kadastrale P-71813068-.....Zona Kadastrale Prizren, vërehet se është i ndërtuar lokali afarist me etazhitet P+0, i cili ka qasje nga ana perëndimore respektivisht nga rruga ..... Në anën e pasme te objektit, respektivisht në anën lindore vërehet se objekti është i ndërtuar me tulla te plota me këto dimensione: gjatësi L=29cm, gjerësi b=14cm dhe trashësi l=6÷7cm (29x14x(6÷7 cm). Në pjesët tjera të lokalit nuk mund të përcaktohet material i ndërtimit pasi që muret janë të suvatuara. Dimensionet e tullave prej të cilave është ndërtuar ky objekt nuk janë të prodhimit serik të cilat i ka prodhuar “Tulltorja në Landovicë” e të cilat janë me dimensione 24x 12x6cm, prandaj mund të konstatohet se lokali afarist në parcelën 02053-0, është i ndërtuar para vitit

1932 kur edhe krijuar kjo ndërmarrje dhe ishte bërë prodhimi serik i tullave. Në anën lindore parcela 02053-0 kufizohet me parcelën 2059-1 në të cilën është e ndërtuar shtëpia individuale e banimit me etazhitet B+P+2, e të paditurit-kundërpaditësit M.S. Në kuadër të parcelës kontestuese në pjesën lindore të saj, bazuar në ekspertizën e Gjeodezisë dhe gjendjes në terren mund të shihet se është e ndërtuar një pjesë e shtëpisë së banimit me etazhitet B +P+2, të cilën është duke e shfrytëzuar i padituri-kundërpaditësi M.S. Kjo shtëpi në etazhen e bodrumit është e ndërtuar me blloka prej betoni, ndërsa dimensione 25x 19x 19cm. Në etazhën e përdhesis, katit të parë dhe katit të dytë ka dritare prej PVC-je, me pamje kah perëndimi. Dritaret janë me dimensione 120x140cm. Në bazë të dokumenteve të lëndës, Kushteve Urbanistike të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm në Prizren, Lejes Ndërtimore të lëshuar po ashtu nga kjo drejtori, materialit të përdorur, si dhe mënyrës dhe formës të ndërtimit mund të konstatohet se kjo shtëpi është e ndërtuar rreth vitit 1985. Në anën lindore të saj, parcela 02053-0 kufizohet me parcelën me numër 2059-2, ku i padituri - kundërpaditësi G.S. e ka të ndërtuar objektin e banimit me etazhitet B+P+2. Në kuadër të parcelës kontestuese në pjesën perëndimore të saj, bazuar në ekspertizën e Gjeodezisë dhe gjendjes në terren mund të shihet se është i ndërtuar një tualet i cili është duke u shfrytëzuar nga i padituri-kundërpaditësi G.S. Nga shtëpia e banimit e të paditurit-kundërpaditësit G.S. nga etazha e përdhesis ka dalje në hapësirën ndërmjet anës së pasme të lokalit të paditësve- kundërpaditësve dhe shtëpisë së banimit, ku nëpërmjet derës prej hekuri e cila ishte me dimensione 85x190cm ka dalje në këtë hapësirë, dhe nga këtu bëhet qasja-hyrja në tualetin i cili është i ndërtuar në parcelën kontestuese. Tualeti në anën e brendshme është me këto dimensione: gjatësia 209cm nga ana perëndimore dhe 215cm nga ana lindore, ndërsa gjerësia e tij është 90cm, e ka të montuar derën hyrëse prej druri me lartësi h=243cm, së bashku me mbi ndriçim dhe është me gjerësi 80cm. Muri i jashtëm është i suvatuar dhe i lyer me gëlqere, po ashtu muret e brendshme dhe plafoni janë të suvatuara dhe të lyer me gëlqere, ndërsa dyshemeja është e shtruar me pllaka të qeramikës. Në dysheme ka të montuar WC guacën (të quajturën turke), dhe e ka një krua- bateri për ujë të ftoftë. Muri i tualetit në anën veriore të tij, pra në anën e pasme tij është i muratuar me blloka giter një pjesë, ndërsa pjesa tjetër është e muratuar me blloka të siporeksit, tek i cili mund të vërehet se janë bërë punime në kohët e fundit dhe vërehet se muri në të kaluarën ka qenë i muratuar me blloka giter prej argjile, dhe vërehet po ashtu se muri është i ngjitur me murin e lokalit të paditësve - kundërpaditurve. Tualeti është i mbuluar me Salonit prej Azbesti të valëzuar dhe një pjese me llamarine po ashtu të valëzuar. Ky tualet është i ndërtuar në formë aneksi të shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit G.S. Periudha e ndërtimit të tualetit duhet të jetë rreth vitit 1976, duke u bazuar në formën e ndërtimit si dhe duke u bazuar në kopjen e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren e cila është pjese e dokumentacionit të lëndës.

Gjykata në shqyrtimin e datës 11.01.2024, ka bërë dëgjimin e ekspertit të ndërtimtarisë S.S. i cili sa i përket deklarimit të tij për sa i përket vjetërsisë së objektit të ndërtuar të lokalit, pra ana lindore e murit ku ka konstatuar se është ndërtuar para vitit 1932, është bazuar në shënimet e marrë nga IMN tulltorja në Landovicë, ku thuhet se kjo ndërmarrje është krijuar në këtë vit dhe në atë periudhë është bërë prodhimi serik i tullave me dimensione të caktuara, ndërsa në rastin konkret dimensionet e tullave me të cilat është ndërtuar lokali janë më të mëdhaja se sa ato të prodhuara standarde nga IMN tulltorja në Landovicë, bazuar në këtë mund të konstatohet se tullat me të cilat është ndërtuar lokali janë prodhuar më herët. Konstatimi është bazuar në

faktin se tullat janë të pjekura nuk janë qerpiq të cilat kanë mundur të prodhohen edhe nga individ, si dhe nga fakti se gjatë ndërtimit të objekteve sigurohen materiale rrethanore për shkak të problemit të transportit në atë periudhë kohore, kur supozohet se është bërë ndërtimi. Ndërsa sa i përket shtëpisë të paditurit M.S. ka deklaruar se datojnë ka viti 1985, duke u bazuar në dokumentacionin e lëndës, materialet e përdorura dhe formën e ndërtimit si është bërë betonimi dhe muratimi.

Gjykata në shqyrtimin e datës 04.04.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitares Gj.A. e cila ka deklaruar se me palët ndërgjyqëse nuk është në lidhje gjaku ose të krushqisë. Dëshmitarja ndër të tjera ka deklaruar se e njëjta tani është 78 vjeçare, gjatë jetës së saj ka shkuar te shtëpia e të paditurve- kundërpaditësve dhe e di vendin të cilin e kanë pasur. Pas shtëpisë së G. dhe M. është një hapësirë – boshllëk, në të cilën hapësirë ka luajtur me shoqen e saj I. prej shtëpisë kanë pasur një kapigjik (derë e drurit) për të dalë në atë hapësirë në të cilën kanë luajtur. Për ballë – karshi shtëpisë së M. dhe G. është murri i kojshiut, në atë mur nuk ka pasur kurgjo, ka qenë vetëm muri i shtëpisë pa derë ose dritare. Gjatë kohës sa dëshmitarja ka luajtur në këtë hapësirë të paditurit kanë pasur shtëpinë e vjetër, ndërsa më vonë M. ka ndërtuar shtëpinë, pastaj edhe G.ka ndërtuar shtëpinë, ndërsa shtëpinë e vjetër e kanë rrënuar. Gjatë kohës kur ka luajtur me kukulla me shoqen e saj në hapësirë në mes shtëpisë së vjetër të të paditurve dhe atij murri nuk ka pas të ndërtuar diçka tjetër. Sa i kujtohet M. e ka ndërtuar shtëpinë në vitin 1984, ndërsa G. e ka ndërtuar pas tij por nuk e di në cilin vjet, ndërsa gjatë kohës sa kanë luajtur në atë hapësirë as nuk janë penguar nga dikush dhe se e njëjta më sa e di në mes të paraardhësit të të paditurve dhe pronarit apo ish pronarit të shtëpisë fqinje nuk kanë pasur ndonjë kontest për këtë hapësirë, ajo nuk ka dëgjuar.

Gjykata në shqyrtimin e datës 04.04.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitares D.K. e cila ka deklaruar se me palët ndërgjyqëse nuk është në lidhje gjaku ose të krushqisë, të njëjtit i ka kojshi. Dëshmitarja ndër të tjera ka deklaruar se të paditurit – kundërpaditësit M. dhe G. i ka përball, pasi dera e saj e shtëpisë është përball derës së shtëpisë së M. ndërsa G. pak më poshtë dhe se vazhdimisht ka shkuar te shtëpia e M. pasi me nënën e tij ka pasur raporte shumë të mira. Ka shtuar se mbrapa shtëpisë së tyre dhe objekti tjetër përball, ekziston një hapësirë, e cila ka qenë ashtu e pa shfrytëzuar, pas shtëpisë së vjetër dhe në të cilën hapësirë ka qenë edhe muri i dyqaneve dhe se në murin e dyqaneve nuk ka pasur dyer apo dritare nga shtëpia e vjetër dhe tani shtëpitë e tyre të reja. Në fund ka deklaruar se më sa e di në mes të paraardhësit të të paditurve dhe pronarit apo ish pronarit të shtëpisë fqinje nuk kanë pasur ndonjë kontest për këtë hapësirë

Gjykata në shqyrtimin e datës 25.04.2024, ka bërë dëgjimin e paditësit – të kundërpaditurit Z.S. në cilësi të palës, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: “ unë jam pronar i tokës për të cilën bëhet fjalë, unë në atë lokal jam prej vitit 1992-1993, fillimisht me qira, kurse në vitin 1999 e kam blerë lokalin me kontratë të cilën e kam bërë te av. Y.K. dhe atë lokal e kam blerë – parcelë e kam blerë me 18m<sup>2</sup>. Kur është bërë blerja e lokalit, kam pas dëshirë të dijë sa metra katror i kam blerë saktësisht dhe sipas matjeve të asaj kohe kam kuptua se kam 2m<sup>2</sup> prapa lokalit. Njëjtën gjë më kanë thënë edhe ish-pronarët serb, kur kam pasur nevojë të bëjë ndërtimin e ri të lokalit, pasi kam bërë kërkesë për ndërtim, aty ekspertët komunal më kanë

treguar saktësisht se pjesa para lokalit nga rruga kryesore diku 50cm është në pronë të Komunës dhe ata më kanë treguar prona e plotë e lokalit tim është prapa. Në kohën kur e kam blerë lokalin këta fqinjët kanë punuar – ndërtuar - diçka prapa, unë së bashku me babën në cilësinë e fqinjës kam dal dhe i kam thënë që të mos punojnë pasi që lokalin e kam blerë unë. Këta më janë drejtuar se kjo është pronë e serbit dhe bëjmë si dojmë, dhe se unë nuk kam drejtë me blerë pa i pyetur këta. Po ashtu dua të shtoj se këtë çështje kam pasur dëshirë ta zgjidhë pa gjykatë, si fqinjë të mirë por fqinjët nuk na lejuan të bëjmë matjet precize dhe jemi detyruar të bëjmë përmes gjykatës ti bëjmë matjet. Pas matjes nga gjykata prapë ju kam ofruar marrëveshje në mënyrë të mos vazhdojmë me gjykatën duke ia paguar edhe shpenzimet gjyqësore, sepse unë kisha nevojë për ndërtim të ri të lokalit pasi që objekti është shumë i vjetër dhe nuk ka ardhur deri te marrëveshja, pasi kemi bërë një marrëveshje me G. që pronën time me liru dhe një pjesë të pronës rreth 1m2 me ma shitë, unë kam pranuar ia kam dhënë të hollat, marrëveshja ka qenë me mare gjeodetin mi përcaktuar pikat në mënyrë precize, kur është bërë vendosja e pikave nga ana e gjykatës, G. ato matje nuk i ka pranuar, dhe pas një muaji është detyruar ti kthejë të hollat në emër të shitblerjes”. Gjatë deklaramit të tij, paditësit-i kundërpadituri Z.S. ndër të tjera ka shtuar se nuk e di saktë që sa kohë e shfrytëzojnë të paditurit këtë pjesë kontestuese të parcelës, por e di që gjithmonë e kanë shfrytëzuar me probleme – konteste, edhe me ish pronarët edhe me neve, më sa e di unë e kanë shfrytëzuar përmes Birlik-njoftësisë, ndërsa kontratën mbi shitblerjen dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, duke ditur dhe pretenduar se pjesa e tokës është e tij, e ka bërë që ti dorëzohet hapësira e tij dhe të blen 1 m2, të pjesës së G. Lokalit që ka blerë, e keni blerë në gjendjen e cila është tash, në murin përkufizues me pasurinë e të paditurve ish pronarët i kanë thënë se ka ekzistuar një derë aty, përndryshe sipas ish pronarëve dhe babës të tij ka pas dalje në vend edhe prej anash, ata i kanë treguar se kanë pasur vazhdimisht kontest, ndërsa palë në kontest dhe atë S.B. nuk e di se kush është, ndërsa paluajtshmërinë e ka blerë nga K.T. dhe J.S.

Gjykata në shqyrtimin e datës 25.04.2024, ka bërë dëgjimin e të paditurit – kundërpaditësit G.S. në cilësi të palës, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: “unë dhe M. – djali i axhës kemi poseduar pronën prej baballarëve tanë, gjë që ata e kanë trashëguar prej gjyshërve prej vitit 1882, dhe unë jam gjenerata e pestë, ndërsa M. gjenerata e katërt në atë shtëpi, dhe deri më sot unë nuk e mbaj në mend që baba na ka treguar se shpesh kemi pasur padi nga ndonjë palë tjetër në lidhje me shtëpinë, përveç të vitit 1976, gjë që ajo është e vërtetuar edhe nga gjykata komunale në Prizren. Z. unë në jetën time e kam parë në vitin 2016, gjë që më është ofruar në shtëpi me babën e tij dhe më ka thënë se unë kam oborr prapa lokalit, unë sipas skicave dhe kopjeve të planit të shtëpisë, e di që nuk kanë dalje, as ndonjë rrugë që mund të shpije aty, nëse dikush pretendon se ka një pjesë të shtëpisë apo lokalit, më së paku duhet të ketë thithëse të ujit dhe kanalizim, gjë që unë posedoj tre thithëse të ujit, shiut dhe një kanalizim dhe po ashtu edhe M. i posedon e që janë nën shtëpitë tona. Kur Z. ka bërë blerjen është dashtë të sqarohet mirë edhe në marrëveshjen e tij dhe të ceket që a ka ndonjë pengesë apo jo. Kështu që nuk di a është ekspertiza e K.G. e sakët pasi që në dokumentacion i mungon licenca e punës. Unë dua të cekim pas matjes të fundit të pronës sime, po vërtetohet që prona ime momentale i ka 83m2, e jo siç është cekur në kopjen e planit prej 86m2, pra tani më mungojnë 3m2. Dua të shtoj se kur kemi bërë marrëveshjen me paditësin Z. kemi pasur të bëjmë matjen e parcelave, matja është bërë por gjeodeti e ka tërheq lëndën, Z. i ka tërheq paret dhe Zefi me atë matje juve iu ka prezantuar

si fakt i pa bazuar”. Gjatë deklaramit të tij, i paditurit- kundërpaditësi G.S. ndër të tjera ka shtuar se në murin e lokalit të paditësve që është në kufijë me pronën e tij, asnjëherë nuk ka pasur as dyer as dritare, përveç daljes nga shtëpia e tyre dhe shtëpia e M.

Gjykata në shqyrtimin e datës 25.04.2024, ka bërë dëgjimin e të paditurit – kundërpaditësit M.S., në cilësi të palës, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: “në vitin 1975 baba jem më ka dhënë këtë kopje të planit mua të datës 23.05.1975, të cilën ia jap në shikim gjykatës, aty shihet hapësira prapa shtëpisë së vjetër e cila ka qenë e ndërtuar me qerpiq rreth 200 vite. Paditësit të cilët po kërkojnë pjesën ku e kanë lokalin, vetëm është dallimi 50cm me dokument, në vitin 11.05.1976, baba jem më ka dhënë edhe një aktvendim me nr. C.nr.209/76, baba jem tha se kemi qenë në gjyq me kojshit serbe, kur erdhi gjyqi në shtëpi tha se ajo pjesa prapa shtëpisë sonë dhe pas lokalit të paditësve, tha se kjo hapësirë i takon shtëpisë me dokument (neve), pas vendimit, kundër të cilit vendim nuk janë ankuar ish pronarët. Në vitin 22.05.1984, kam kërkuar leje prej Komunës për ndërtim të shtëpisë familjare, prej Komunës dy arkitektë kanë ardhur në vend – parcelë dhe më lejuan që të ndërtoj shtëpinë në vend të shtëpisë së vjetër, më dhanë vendimin me nr. 353 / 1072, po ashtu unë kam nxjerrë edhe kopjen e planit në të cilën shihet hapësira prapa shtëpisë. Në kohën kur kojshit kanë filluar të na thërrasin në gjyq, unë kam shkuar në Krushevac për të nxjerrë kopjen e planit, ku edhe këtu shihet hapësira prapa shtëpisë time. Me datë 16.09.2015 e thirra gjeodetin për të matë shtëpinë – parcelën time, gjeodet ka qenë djali i gjeodetit K.G. ku ka konstatuar se hapësira prapa shtëpisë na takon neve. Sa i përket pretendimit të paditësve se në murin e lokalit ka pasur derë-dritare, në fotografi e shkresave të lëndës shihe qartë se nuk ka kurrfarë dalje”. Gjatë deklaramit të tij, i padituri- kundërpaditësi M.S. ndër të tjera ka shtuar se në murin e lokalit të paditësve që është e kthyer nga hapësira kontestuese nuk ka pasur, as dyer as dritare. Shtëpinë e tij e ka ndërtuar në vitin 1984, bazuar në vendimin e komunës dhe se prej shtëpisë së tij ka dritare, të cilën e ka parë gjykata me rastin e shikimit në vend. Kur ka qenë e ndërtuar shtëpia e vjetër ka pas derë, ndërsa kur e kanë ndërtuar shtëpinë e re, për shkak të plloqës kanë vendosur dritare, pasi për shkak të plloqës nuk kanë mundur ta vendosin derën. Shtëpia e re është ndërtuar në temelat e shtëpisë së vjetër me leje të komunës, në këtë rast 50cm, hapësirë kanë lënë për shkak të dritares në katin e parë, dytë dhe tretë dhe uji që do të shkon në kanalizim i cili vjen prej olluqeve. Në fund ka shtuar se shtëpia e tyre nga prapa është fqinjë me 6 lokale, me asnjë lokal deri më sot nuk kanë pasur problem, përveç problemit me Z. në vitin 2023 me njërin nga fqinjët pronar i lokalit me emrin K.G. kanë pasur një kontest.

### 3.Baza ligjore dhe Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, është me rëndësi të theksohet se Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 46 paragrafi 1 thotë: “E drejta e pronës është e garantuar”, ndërsa paragrafi 3 thotë: “Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona”. Po ashtu edhe me Protokollin shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përkatësisht në nenin 1 parashihet që “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe

*në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*

Lidhur me kërkesën e paditësve për dorëzimin e paluajtshmërisë e cila kërkesë pranë kësaj gjykate është paraqitur në vitin 2018, gjykata vlerëson se si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), i cili në nenin 18 par 1 thotë *“Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.”*. Kurse me nenin 93 të po këtij ligji, është përcaktuar se *“Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”*.

Ndërsa duke pasur parasysh kohën në të cilin të paditurit – kundërpaditësit pretendojnë se e kanë në posedim pjesën e ngastrës kontestuese, përkatësisht paraardhësit e tyre, gjykata vlerëson se lidhur me kërkesën e tyre për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, si ligj i zbatueshëm paraqitet të jetë Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (më tutje si LMTHJP), i cili është i zbatueshëm bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr.1999/24 (gazeta zyrtare e RSFJ nr.6/80). Sipas nenit 20 par. 1 të këtij ligji përcaktohet se: *“e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”*. Pastaj, me nenin 21 të LMTHJP-së theksohet që: *“sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzierje, **me ndërtim në tokën e huaj**, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj”*. Sipas nenit 24 par.1 të po këtij ligji thuhet se *“Personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objektin ndërtimor) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po qe se nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë”*.

Përfundimisht me Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK), nr. 03/L-006 (gazeta zyrtare Republikës së Kosovës nr. 38/20 shtator 2008) me nenin 7.1 është paraparë që *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me nenin 319.1 të po këtij ligji parashihet që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, ndërsa me nenin 322 par. 1 dhe 2 parashihet që *“1 Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. 322.2 Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër.”*

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve – të kundërpaditurve Z.S. dhe P.S. është pjesërisht e bazuar, kërkesëpadia e të paditurit –

kundërpaditësit M.S. është pjesërisht e bazuar ndërsa kërkesëpadia e të paditurit – kundërpaditësit G.S. është në tërësi e pabazuar.

Për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit-të kundërpaditurit Z.S. dhe P.S. janë pronarë të lokalit i cili gjendet në ngastrën kadastrale numër 2053-0 ZK Prizren, ndërsa i paditurit-kundërpaditësi M.S. është pronarë i ngastrës 2059-1 ZK Prizren, në të cilën ka të ndërtuar shtëpinë si dhe i padituri-kundërpaditësi G.S. është pronarë i ngastrës 2059-2 ZK Prizren, në të cilën ka të ndërtuar shtëpinë. Kontestuese ishte fakti nëse të paditurit-kundërpaditësit duhet të lironin pjesa e ngastrës me numër 2053-0 ZK Prizren, e cila gjendet pas lokalit të paditësve-kundërpaditurve në sipërfaqe të përgjithshme prej 3.57 m<sup>2</sup>, apo nëse të paditurit-kundërpaditësit këtë pjesë të ngastrës kadastrale e shfrytëzonin me mirëbesim dhe mbi të njëjtën e kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të mbajtjes dhe të ndërtimit.

Si rrjedhojë, pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit Z.dhe P.S. nga Prizreni, janë pronarë të ngastrës kadastrale me numër 2053-0, me të drejtën e pronës prej ½ të ngastrave kadastrale. Ndërsa të drejtën e pronësisë paditësit – të kundërpaditurit e kanë fituar në bazë të Kontratës mbi Dhuratën LRP.nr.6610/14, Ref.nr.1329/14, të datës 22.09.2014, tek noter O.G. Kështu që paditësit përveç titullit juridik (justus titulus) për fitimin e të drejtës së pronësisë (shpalljen si trashëgimtarë ligjor), këtë të drejtë e kanë regjistruar edhe në regjistrin kadastral (modus aquirendi), ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të përmendura më lartë (të cilat vërtetohen nga certifikata e pronësisë dhe ekspertiza e gjeodezisë e punuar nga eksperti K.G. të cilës ekspertizë gjykata ja fali besimin e plotë). Andaj, gjykata bazuar në të lartcekurat vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve – të kundërpaditurve dhe duke detyruar të paditurin – kundërpaditësin G.S. nga Prizreni, që të liron - zbraz nga të gjitha personat dhe gjësendet sipërfaqen prej 2.0 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.75m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 1.33m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.45m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në vijë të lakuar në gjatësi prej 1.39m (0.55 + 0.84m), pronë e paditësve-kundërpaditurve Z. dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-..... ZK Prizren, dhe të paditurin – kundërpaditësi M.S. nga Prizreni, që të liron - zbraz nga të gjitha personat dhe gjësendet sipërfaqen prej 0.69 m<sup>2</sup> (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.41m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.63m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.44m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.34m, pronë e paditësve-kundërpaditurve Z. dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-2053-0 ZK Prizren. Kjo pasi që bazuar në nenin 93 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS), që është tani në fuqi, paditësit – të kundërpaditurit (pronarët) kanë të drejtë të kërkojnë kthimin në posedim të pjesës së ngastrës kadastrale të përshkruar si më lartë, ngase mbajtësit këtu të paditurit - kundërpaditësit këto pjesë të ngastrës i posedojnë dhe i shfrytëzon pa ndonjë bazë të vlefshme juridike.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht kërkesën nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit M.S. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar fitimin e të drejtës së pronësisë në sipërfaqen prej 1.19m<sup>2</sup> (sipërfaqe në të cilën ndodhet e ndërtuar shtëpia e të paditurit- kundërpaditësit M.S.), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.39m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.73m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.41m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.98m, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-.... ZK Prizren, dhe atë mbi bazën e ndërtimit në tokën e huaj. Nga ekspertiza e gjeodezisë e punuar nga eksperti K.G. dhe ekspertiza e ndërtimtarisë, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri – kundërpaditësi M.S. nga Prizreni, në këtë pjesë të hapësirës së ngastrës kontestuese ka të ndërtuar shtëpinë familjare dhe se kjo shtëpi është e ndërtuar rreth vitit 1985. Në fakte, në bazë të provave të administruara në këtë procedurë (dëgjimi i dëshmitarëve Gj.A. dhe D.K. dhe vendimit me numër 04/4-351-238 të datës 28.05.1984 lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Komunale dhe Banesore pranë Komunës së Prizrenit me të cilin i është lejuar M.S. ndërtimi i objektit të ri të banimit familjar), provohet se i padituri-kundërpaditësi M.S. shtëpinë e ka ndërtuar në vendin në të cilin ka qenë e ndërtuar shtëpia e vjetër dhe se nuk ka ditur se një pjesë të shtëpisë është duke e ndërtuar në tokën e huaj. Duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar dhe nenin 21 të LMTHJP-së, ku është përcaktuar se e drejta e pronësisë sipas vetë ligjit fitohet edhe *me ndërtim në tokën e huaj*, dhe nenin 24 par. 1 të po këtij ligji ku thuhet se *“Personi që mund të jetë bartës i së drejtës së pronësisë, e që ndërton ndërtesën ose godinën tjetër (objektin ndërtimor) në tokën mbi të cilën tjetri ka të drejtën e pronësisë (ndërtuesi), fiton të drejtën e pronësisë edhe mbi tokën në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor, si dhe mbi tokën që është e domosdoshme për përdorimin e rregullt të këtij objekti ndërtimor, po qe se nuk ka ditur, as që ka mundur të dinte se po ndërton në tokën e huaj, kurse pronari i tokës ka pasur dijeni për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë”*, pra kur të merre për bazë gjendja faktike e vërtetuar dhe këto dispozita ligjore të LMTHJP-së, gjykata vlerësoj se janë plotësuar kushtet ligjore sipas kësaj dispozite që i padituri-kundërpaditësi M.S. të fiton të drejtën e pronësisë në sipërfaqen në të cilën e ka të ndërtuar objektin familjar të banimit. Pastaj me rastin e blerjes së ngastrës me numër 2053-0 ZK Prizren, fillimisht nga paraardhësi F.S. dhe fitimin e pronësisë nga këtu paditësit – të kundërpaditurit në bazë të kontratës së dhuratës, i padituri M.S. ka pasur të ndërtuar shtëpinë e tij familjare në këtë hapësirë kontestuese. Po ashtu në vetë deklaratimet e paditësve-kundërpaditurëve të dhënë pranë kësaj gjykate kanë deklaruar se me rastin e blerës së lokalit nga ishe pronaret janë njoftuar se mbrapa lokalit gjendet hapësira prej 2 metra pjesë e ngastrës 2053-0 ZK Prizren, pra nuk i është thënë dhe pohuar fakti se i padituri-kundërpaditësi M.S. ka të ndërtuar një pjesë të shtëpisë së banimit në ngastrën objekt kontesti, dhe se është kundërshtuar nga të njëjtit se po ndërton në tokën e huaj, andaj gjykata ka vendosi si në pikën II të këtij aktgjykimi, duke aprovuar pjesërisht kërkesën nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit M.S. për fitimin e të drejtës së pronësisë në sipërfaqe prej 1.19m<sup>2</sup> në ngastrën me numër 2053-0 ZK Prizren mbi bazën e ndërtimit.

Meqenëse gjykata e ka aprovuar pjesërisht kërkesën nga kundërpadia e të paditurit-kundërpaditësit M.S. për vërtetimin e pronësisë në sipërfaqe 1.19m<sup>2</sup> në ngastrën me numër



2053-0 ZK Prizren mbi bazën e ndërtimit në tokën e huaj, atëherë vetvetiu kërkesëpadia e paditësve-kundërpaditurëve për lirimin e sipërfaqes prej 1.19m<sup>2</sup> në ngastrën me numër 2053-0 ZK Prizren u deshe të refuzohet si e pa bazuar, sepse me rastin e fitimit të pronësisë nga ana e të paditurit-kundërpaditësit në ngastrën kontestuese ai i ka fituar të gjitha atributet që ka pronari në raport me pronën e tij **“mbaj, disponoj dhe shfrytëzoj”**, dhe të gjithë ti përjashtoj nga ndikimi në pronën e tij dhe me këtë rast paditësit- të kundërpaditurit Z. dhe P.S. janë zhveshur nga këto të drejta dhe kërkesa e tyre për dorëzimin e pjesës kontestuese tani më s’ka bazë ligjore, sepse tani i padituri-kundërpaditësi M.S. në bazë të ndërtimit në tokën e huaj është pronari në sipërfaqen pjesën e ngastrës objekt i këtij kontesti.

Gjykata e konsideron si të nevojshme sqarimin e kushteve (elementeve) që posedon parashkrimin fitues si bazë e ligjshme për fitimin e të drejtës së pronësisë, e të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar dikush të drejtën e pronësisë mbi një send të paluajtshëm. Në këtë drejtim gjykata vlerëson se parashkrimi fitues në vete përmban katër elemente: (1) mbajtësi i ligjshëm, (2) mirëbesimi, (3) kalimi i periudhës kohore të caktuar me ligj dhe (4) posedimi i sendit mbi të cilin dikush tjetër e ka të drejtën e pronësisë. Posedimi i mbajtësit është “i ligjshëm” nëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit, ndërsa posedimi mund të jetë ligjor dhe pa pëlqim, por mund të jetë i paligjshëm, por me pëlqim. Më tutje posedimi konsiderohet se është me mirëbesim, po që se mbajtësi nuk e di ose nuk mund ta dijë se sendi nuk është i tij, ndërsa në raste të caktuara mirëbesimi supozohet. Në lidhje me elementin e tretë që ka të bëjë me kalimin e periudhës kohore të caktuar me ligj, gjykata fillon numërimin prej ditës në të cilën zotëruesi ka fituar të drejtën e posedimit të objekti (sendit), ndërsa në këtë periudhë mund të përfshihet edhe koha kur pala paraardhëse ka mbajtur sendin si zotërues i ligjshëm dhe me pëlqim, ndërsa periudhën kohore që duhet të kalojë për fitimin e të drejtës së pronësisë e parasheh ligji (LMTHJP apo LPDS). Elementi i katërt ka të bëjë me posedimin e sendit mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, por mendon se sendi është i tij dhe nuk i përket dikujt tjetër.

Gjykata vendosi si në pikën IV dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën tjetër të kërkesës nga kundërpadia e të paditurit –kundërpaditësit Muhamed Surdulli, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të parashkrimin fitues është pronarë i sipërfaqes prej 0.69 m<sup>2</sup>, (sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore prej pikës 1 deri në pikën 2 në gjatësi prej 1.41m, nga ana Veriore prej pikës 2 deri në pikën 3 në gjatësi prej 0.63m, nga ana Perëndimore prej pikës 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.44m dhe nga ana Jugore prej pikës 4 deri në pikën 1 në gjatësi prej 0.34m, pronë e paditësve-kundërpaditurëve Zef Sakica dhe Prek Sakica, pjesë e ngastrës kadastrale P-71813068-2053-0 ZK Prizren dhe kërkesën nga kundërpadia e të paditurit –kundërpaditësit Gani Sunduri, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të parashkrimin fitues është pronarë i sipërfaqes prej 2.00 m<sup>2</sup> ( sipërfaqe e cila gjendet ndërmjet lokalit afarist të paditësve-kundërpaditurëve dhe shtëpisë së të paditurit- kundërpaditësit), me dimensione nga ana Lindore nga pika 1 deri në pikën 2 në gjatësi të përgjithshme prej 1.75m, nga ana Veriore nga pika dy deri në pikën 3 në gjatësi prej 1.33m, nga ana Perëndimore nga pika 3 deri në pikën 4 në gjatësi prej 1.45m dhe nga ana

Jugore nga pika 4 deri në pikën 1 ne vijë te lakuar në gjatësi prej 1.39m (0.55 + 0.84m), pronë e paditësve-kundërpaditurve Z.S. dhe P.S. të dy nga Prizreni, e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-71813068-.... ZK Prizren, pasi që të paditurit – kundërpaditësit nuk arritën të vërtetonin faktin se e shfrytëzonin hapësirën e cila gjendet në mes të shtëpive të tyre dhe lokalit të këtu paditësve – të kundërpaditurve me mirëbesim, ashtu si pretendonin në kundërpadi dhe gjatë deklamimeve në këtë çështje juridike kontestimore. Gjykata në këtë çështje ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarëve Gj.A. dhe D.K. si dhe dëgjimin e të paditurve-kundërpaditësve, mirëpo deklarimeve në fjalë gjykata nuk ia fali besimin sa i përket posedimit të kësaj hapësire me mirëbesim. Kjo duke u bazuar edhe në provën e dorëzuar nga vetë të paditurit-kundërpaditësit, aktvendimin me numër c.nr.209/76, të datës 11.05.1976, të lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren, nga e cila provë gjykata vërtetoi faktin se këtu të paditurit – kundërpaditësit kanë qenë të informuar rreth kontestit sa i përket të drejtës së pronësisë dhe shfrytëzimit të hapësirës e cila gjendet pas lokalit të tani paditësve dhe shtëpive të tyre dhe se që atëherë ka qenë kontestuar posedimi i kësaj hapësire dhe në këtë rast të paditurit – kundërpaditësit nuk mund të thirren në posedimin e kësaj hapësire me mirëbesim, pasi që mirëbesimi nuk ka ekzistuar, as në kohën kur pretendojnë që atë hapësirë e kanë shfrytëzuar paraardhësit e tyre, e më vonë edhe vet të paditurit – kundërpaditësit.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor (leximi i aktvendimit të lëshuar nga drejtori i punëve të brendshme pranë Këshillit Ekzekutiv Krahinor të Këshillit Popullor krahinor të KAKM, me numër rendor 215/H, i datës 10.11.1947, Prishtinë; leximi i skicës së matjes për ngastrën kadastrale 2059-1, nga gjeodet i licencuar N.Sh. Geoline, e datës 16.09.2015; raportin për njësinë kadastrale P-02053-0, të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me datë 20.09.2021; leximi i kopjes nga lista poseduese me numër 299, datë 22.09.1995, e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Prizren, për parcelën me numër 2053, 2163 dhe 3387, fotografi color e formatit A4 në të cilën shihet pjesa e përparme e lokalit të paditësve dhe skica pa ngjyra e formatit A4 në të cilën shihet parcela e paditësve dhe parcelat e të paditurve), si dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqësore, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Gjykata, i pati parasysh të gjitha pretendimet e të autorizuarit të të paditurve –kundërpaditësve, sa i përket ekspertit të gjeodezisë K.G. mirëpo të njëjta i gjeti si të pa baza, kjo për faktin se ekspertiza lidhur me ngastrën P-71813068-.... ZK Prizren objekt kontesti ka qenë e plotë, ndërsa me propozimit e të paditurve-kundërpaditësve është aprovuar plotësimi i saj me qellim të matjes së ngastrave të të paditurve, mirëpo meqë të njëjtit nuk kanë bashkëpunuar me ekspertit dhe me qellim që çështja objekt kontesti të mosprolongohet, gjykata ka shfuqizuar aktvendimin e saj për plotësimin e ekspertizës.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori bazuar në nenin 452.1, lidhur me nenin 463, të LPK-së dhe TA-së, ku e obligoi palën e paditur G.S. si palë qe e ka humbur kontestin, që paditësve në emër të shpenzimeve procedurale ti paguajë shumën e përgjithshme prej 2,109.20 euro dhe atë: për padi shumën prej 104.00 euro, për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro, në emër të ekspertizës së gjeodezisë shumën prej 150.00 euro dhe për

përfaqësimin në 9 seanca të mbajtura nga 202.80€ (9x202.80=1,825.20€). Gjykata nuk ja njohu taksën gjyqësore të kërkuar në lartësi prej 100.00 dhe shpenzimet e ekspertit në lartësi prej 250.00 euro, pasi nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësit kanë paguar taks gjyqësore në lartësi prej 30.00 euro, ndërsa shpenzimet e ekspertit të gjeodezisë kanë qenë të caktuar në lartësi prej 150.00, andaj edhe nuk ia ka njohur shumën mbi vlerën e caktuar më lartë. Po ashtu lartësia e shumës së kërkuar për përfaqësim në seancë nga pala paditëse është 234.00€, ndërsa bazuar në TA-së, përfaqësimi në kontestet civile deri në 10.000 euro, për dy paditës/të paditur është 202.80 euro, andaj u vendos si në pikën VI të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e lidhur me nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2019:095968, 27.08.2024

**G j y q t a r i,**

---

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.